



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:220670
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644282

KPPP.nr.1286/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T “OPOJA” me NUI 810346090, me seli në rrugën “Mbretëresha Teutë” Mitrovicë, kundër debitorit “Hotel Palace & SPA Center” Sh.p.k me NUI 811327635 me seli në fshatin Shupkovc, Komuna Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.247/21 të datës 20.09.2021, të Përmbartuesit Privat Ilmi Miftaraj me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Hotel Palace & SPA Center” Sh.p.k i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.247/21 të datës 20.09.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.247/21 të datës 20.09.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.T “OPOJA”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.247/21 të datës 20.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës numër Fatura nr. 0075914 e datës 14.08.2019, Fatura nr. 0075915 e datës 15.08.2019, Fatura nr. 0075916 e datës 16.08.2019, Fatura nr.0075917 e datës 17.08.2019, Fatura nr. 0075918 e datës 18.08.2019, Fatura nr. 0075919 e datës 19.08.2019, Fatura nr. 0075920 e datës 24.08.2019, Fatura nr. 0075921 e datës 25.08.2019, Fatura nr.0075922 e datës 31.08.2019, me të cilat e ka urdhëruar debitorin, që t’ia

paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekur shumë prej 920.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të propozimit për përmbaerim si dhe shpenzimet e procedurës përmbaerimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton propozimin për përmbaerim për arsye se faturat që pretendon që i takojnë debitorit nuk janë të regjistruara dhe pranuar malli nga debitori, gjithashtu edhe faturat e bashkangjitura nuk i kanë elementet kryesore të faturës për pranimin e mallit, në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovet si i bazuar prapësimi ndërsa urdhri përmbaerimor të anulohet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet debitorit si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se me debitorin kanë pasur raporte të mira afariste, lidhur me pretendimin për fatura ky pretendim nuk qëndron pasi që të gjitha dërgesat janë dorëzuar tek kuzhinjerët e debitorit, shumica e faturave janë nënshkruar pa as një vërejtje por ka pasur mundësi që gjatë periudhës ndonjë faturë të mos nënshkruhet nga fakti se kuzhinjerët ishin të zënë me punë dhe në pa mundësi objektive është lënë në mirëbesim, pasi që ka pasur një kohë shumë të gjatë të bashkëpunimit mbi 5 vite pa pasur as një vërejtje, duke i propozuar gjykatës në fund që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi ndërsa urdhri përmbaerimor të lihet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbaerim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshëm për përmbaerim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbaerimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaerim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht faturat e lartcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar asnjëherë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarrimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se urdhri për përmbarrim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1286/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.